

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pagat e magjistratëve/ GJKKO, Gjykata e Lartë dhe shoqatat e magjistratëve refuzojnë ftesën e Ramës: Çështja është ende në Gjykatën Kushtetuese - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/pagat-e-magjistrateve-gjkk-gjykata-e-larte-dhe-shoqatat-e-magjistratev-e-refuzojne-ftesen-e-rames-ceshtja-eshte-ende-ne-gjykatën-kushtetuese/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 08:34:11 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 08:32:59 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	69ab5a27f60e165149ef90a8967141e7f307a78f2430398b2bcec269e7b7400d
TEKSTI	4d260e105e6f2b6985955823bb9cab08b66ac26f2becc26c0d57c371abe7de6c
PAMJA	d70f805ba4bbe0691edb496eecd3a6758f269a631f6114ff5f19f97cc4289cf1

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f66a54a59b7493ca015160ba2f626a5729c000a55cfde403b6630598f84414eb
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b28949f398f9c40f36f567d35f036ed2a879d9ccf77f144b0ee032f95e15789d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f66a54a59b7493ca015160ba2f626a5729c000a55cfde403b6630598f84414eb>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » Pagat e magistratëve/ GJKKO, Gjykata e Lartë dhe shoqatat e magistratëve refuzojnë ftesën e Ramës: Çështja është ende në Gjykatën Kushtetuese

AKTUALITET

Demo

Pagat e magistratëve/ GJKKO, Gjykata e Lartë dhe shoqatat e magistratëve refuzojnë ftesën e Ramës: Çështja është ende në Gjykatën Kushtetuese

SEPTEMBER 28, 2026



Ftesa e kryeministrit Edi Rama për një tryezë konsultimi mbi pagat e magistratëve është refuzuar nga GJKKO, Gjykata e Lartë, Unioni i Gjyqtarëve, Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve dhe Shoqata e Prokurorëve.

Ato thonë se nuk do të marrin pjesë në diskutimet për një skemë të re pagash, pasi ligji i ri që u miratua nga Kuvendi tashmë është dërguar në Gjykatën Kushtetuese dhe se duhet pritur vendimarrja e saj përpara se kjo çështje të diskutohet me qeverinë. Megjithatë, magistratët theksojnë se refuzimi i kësaj tryeze nuk nënkupton mbylljen e dialogut mes institucioneve.

Në një përgjigje drejtuar Kryeministrit, kreu i Gjykatës së Lartë Sokol Sadushi thotë se në kushtet kur çështja e pagave të magistratëve është në duart e Gjykatës Kushtetuese, diskutimi për këtë temë do të ishte i pavend.

"Për një çështje kushtetuese tashmë të shtruar për gjykim, fjala i përket Gjykatës Kushtetuese. Për rrjedhojë, dialogu për këtë objekt mund të jetë substancial dhe efektiv pasi ajo të jetë shprehur", thuhet në përgjigjen e Gjykatës së Lartë.

Ndërsa GJKKO, në një reagim për Report tv mediat sqaron se i ka kthyer përgjigje Kryeministrit se nuk marrin pjesë në atkim, pasi janë në pritje të vendimit të Kushtetueses.

"Ditën e premte më datë 25.09.2026 GJKKO i ka kthyer përgjigje zyrtare që nuk do të marrë pjesë në takim pasi është në pritje të vendimit të Gjykatës Kushtetuese", thuhet në reagimin e GJKKO.

Të njëjtin argument sjell edhe Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë si edhe Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve, të cilat thotë se nuk mund të marrin pjesë në një tryezën për pagat deri në përfundimin e procesit të nisur nga shoqatat e magistratëve në Kushtetuese.

"Deri në një vendimarrje të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me padinë e paraqitur nga shoqatat e magistratëve, është e pamundur për ne pjesëmarrja në tryezën e konsultimit të datës 28 shtator 2026", thotë Unioni i Gjyqtarëve.

"Shoqata vlerëson se nuk do të ishte e përshtatshme pjesëmarrja e saj në një diskutim institucional mbi të njëjtën çështje përpara përfundimit të këtij procesi", thekson Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve.

Në të njëjtën linjë është Shoqata e Prokurorëve, e cila kërkon që tryeza të shtyhet deri në një qëndrim të Gjykatës Kushtetuese, në mënyrë që diskutimi me qeverinë të zhvillohet mbi një kuadër të qartë kushtetues.

"Duke pasur parasysh se çështja objekt i konsultimit lidhet drejtpërdrejt me një proces kushtetues të

Postimet e reja

Pagat e magistratëve/
GJKKO, Gjykata e Lartë...

SEPTEMBER 28, 2026

I dënuar me burg përjetë,
Laert Haxhiu kërkesë në...

SEPTEMBER 28, 2026

Disfata e Gjermanisë në
Nations League,...

SEPTEMBER 28, 2026

Hoxha takim me Kryetarin
e Komisionit për Çështje...

SEPTEMBER 28, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 24, 2026

Dosja/ Biznesmeni Meqemeja i dha Ahmetajt 140 mijë euro! SPAK: Shpërblim për Inceneratorin e Fierit përmes shitjeve fiktive

Biznesmeni Sokol Meqemeja njihet si pronar i disa kompanive apo sipërmarrjeve. Përveç 'Delvina Gas' ai...

ALERT në Slloveni për VIPA
Flips të Kosovës, kanë
përmbytje të alergjenësh.
Produkti hiqet nga tregu

Kreditorët te dera, gjykata
në kërkim të "Top Fruits"
të Ejup Ahmetit dhe Marin
Gjonajt: Paraqituni në gjyq

Kompania e krijuar tri ditë
pas hapjes së thirrjes për
grantet e startupeve fitoi
6.1 milionë lekë në fazën e
rezervuar për biznese të
paktën 1-vjeçare

Na ndiq

iniciuar nga shoqatat e magjistratëve pranë Gjykatës Kushtetuese, kërkojmë që një tryezë e tillë të vlerësohet të zhvillohet pas një qëndrimi të Gjykatës Kushtetuese mbi çështjen", thotë Shoqata e Prokurorëve.

Shoqatat e ndryshme të magjistratëve iu kundërvunë hapur qasjes së shumicës, e cila nuk ndërmori asnjë veprim që të miratonte një formulë të re brenda 31 korrikut të këtij viti, siç udhëzonte Gjykata Kushtetuese. KLGJ dhe KLP ndërmorën vendime të posaçme duke miratuar ato vetë nivelin e pagave për muajin gusht, duke iu referuar vendimit të GJK. Situata çoi në një përplasje mes ekzekutivit dhe institucioneve të Drejtësisë. Ministria e Financave nuk miratoi veprimet e Thesarit për kalimin e pagave sipas vendimeve të KLGJ dhe KLP-së. Magjistratët u përgjigjën duke kallëzur në SPAK, ministrin e Financave dhe duke vënë në lëvizje gjykatën administrative e cila urdhëroi anulimin e vendimit të ministrit, dhe kalimin e pagave për gjykatat e prokuroritë në të gjithë vendin.

Në parlament, shumica miratoi më 18 shtator, me 84 vota pro formulën e re të pagave të magjistratëve që përcakton se paga referuese e magjistratëve do të jetë sa 38% e pagës së Presidentit të Republikës nga 36% që ishte, me një rritje prej rreth 8500 lekësh. Rritja me 8500 lekë e pagës referencë është 9-fish më e vogël se ajo që vetë magjistratët thonë se ka vendosur GJK. Tre ditë më pas, më 21 shtator, shoqatat e gjyqtarëve dhe prokurorëve dorëzuan në Kushtetuese kërkesën për pezullimin e formulës së miratuar nga parlamenti dhe shfuqizimin e saj.

aktualitet	çështja në Gjykatën Kushtetuese	Drejtësia	Drejtësia shqiptare	Edi Rama	ftesa e Ramës
GJKKO	Gjykata e Lartë	Gjykata e Posaçme	Gjykata Kushtetuese	gjyqtarët	institucione të drejtësisë
lajme	lajme Shqipëri	Magjistratët	magjistratura	pagat e gjyqtarëve	pagat e magjistratëve
pagat e prokurorëve	politikë	prokurorët	Reforma në drejtësi	shoqatat e magjistratëve	shqipëri
sistemi i drejtësisë	Tiranë	vendimi i Gjykatës Kushtetuese			

SHARE.



RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A
Email: radarlajme@gmail.com
Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Dashuri, vendime dhe mundësi të reja: Si do të shkojë e diela për secilën shenjë

Horoskopi/ Parashikimi i vjeve për ditën e sotme, 24 Shtator 2026

Njohje të reja për beqarët, mundësi fitimi dhe sfida në punë, çfarë thonë yjet për ju sot



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

raporto këtu

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.